REPUBLIKA E SHQIPËRISË

AUTORITETI RRUGOR SHQIPTAR

TERMA REFERENCE

PËR OBJEKTIN

“ Studim Projektim zgjerimi i segmentit rrugor dalje Elbasan – Përrenjas – Qafë Thanë ”

TIRANE 2020

I. TË PËRGJITHSHME

Autoriteti Rrugor Shqiptar me buxhetin e shtetit 2020 dhe në vazhdim ka planifikuar të financojë projektin me objekt **" Studim Projektim, zgjerimi i segmentit rrugor dalje Elbasan-Përrenjas-Qafë - Thanë".**

HYRJE

Republika e Shqipërisë ndodhet në Europën Juglindore në brigjet perëndimore të Gadishullit të Ballkanit. Ajo shtrihet ndërmjet gjerësive veriore $39^0 38'$ dhe $42^0 39'$ dhe gjatësive lindore $19^0 16'$ e $21^0 40'$. Largësia më e madhe ndërmjet pikës më veriore dhe asaj më jugore është 335 km dhe ndërmjet pikës më lindore dhe asaj më perndimore 150 km. Shqipëria e ka sipërfaqen 28.748 km^2 dhe kufizohet: nga jugu, me Greqinë; nga lindja, me Maqedoninë; nga veriu dhe veriperëndimi, me Malin e Zi; nga veriu e verilindja, me Kosovën. Nga perëndimi laget prej detit Adriatik dhe nga jugperëndimi prej atij Jon. Gjatësia e përgjithshme e kufirit të Shqipërisë është 1.094 km. Kufijtë tokësor, detar, liqenor dhe lumore janë përkatësisht: 657 km, 316 km, 73 km dhe 48 km. Vija bregdetare është 427 km e gjatë: 273 km i përkasin bregdetit të Adriatikut dhe 154 km bregdetit të Jonit.
Bazuar në të dhënat e Regjistrimit të Popullsisë në vitin 2011, rezulton se popullsia e Shqipërisë është 2 ,895,947 banorë.

Terreni që përshkruan Shqipërinë është 70% terren malor dhe pjesa tjetër fushor, kodrinor e bregdetar.

Shqipëria ka një klimë mesdhetare. Për shkak të relievit të saj malor të thyer, klima ka një larmi të madhe në të gjithë vendin. Shqipëria karakterizohet me verë të thatë dhe të nxehtë, dhe përgjithësisht dimër të ftohtë, të butë dhe me rreshje të shumta. Në Alpet Shqiptare në zonën e veriut, dimri është i ftohtë dhe vera e freskët. Zakonisht, harku kohor Qershor-Shtator karakterizohet prej një kohe të nxehtë me diell, ndërsa Tetor-Maj, freskët/ftohët dhe lagështi.

INFORMACION I PËRGJITHSHËM

Në Shqipëri operon:
Transporti ajror civil ndërkombëtar cili kryhet nëpërmjet aeroportit "Nënë Tereza" në Rinas, i vetmi aeroport që kryen transport të këtij lloji.
Transporti hekurudhor. Gjatësia e linjës hekurudhore në shfrytzim është 409 km. Transporti hekurudhor në vitin 2019 krahasuar me vitin 1990 ka shënuar një rënie të volumit të punës së tij si në atë të mallrave ashtu dhe në atë të pasagjerëve, rënie kjo e shkaktuar kryesisht nga konkurrenca e këtij lloj transporti nga transporti automobilistik por dhe si rezultat i gjëndjes së përkeqësuar të infrastrukturës së këtij lloj transporti.
Transporti detar. Transporti detar në Shqipëri kryhet nëpërmjet 4 porteve: Durrësi, Vlora, Saranda dhe Shëngjini. Porti më i madh dhe më i rëndësishëm është ai i Durrësit si dhe porta hyrëse e korridorit të VIII për Shqipërinë e që vazhdon deri në kufi me Maqedoninë.
Transporti rrugor është më i rëndësishmi në Shqipëri. Sipas Planit Strategjik të Transportit të hartuar në 2011, Rrjeti Kombëtar Rrugor në Shqipëri është rreth 18,000 km i gjatë duke përfshirë 3 636 km rrugë kombëtare, 10 500 km rrugë ndër urbane dhe pjesa tjetër prej 4000 km është nën juridiksionin e njësive të pavarura, ndërmarrjeve ose firmave.

Rrjeti kombëtar rrugor përbëhet nga:
Rrjeti parësor rrugor i cili është rreth 1198 km i gjatë me nëntë lidhje kryesore që përbëjnë rrjetin bazë;
Rrjeti dytësor i cili është rreth 2083 km i gjatë;
Dhe pjesa tjetër janë rrugë të planifikuara për ndërtim.

Gjithë rrugët në rrjetin parësor rrugor dhe 67% e gjatësisë së përgjithshme të rrjetit dytësor janë rrugë të asfaltuara. Rreth 48% e gjatësisë së përgjithëshme të rrjetit parësor gjenden në terren të sheshtë dhe 56% e rrugëve në rrjetin dytësor gjenden në terren malor.

Komponent kryesor të Rrjetit Rrugor Nacional janë korridoret:

Korridori Veri-Jug.
Ka një gjatësi prej 374 km (me shtrirje nga Hani i Hotit në Kakavijë) në të cilin përfshihen segmentet rrugore:
Shkodër-Han i Hotit; Lezhë-Shkodër; Lezhë- Milot;
Milot -Mamurras (*ky segment është dhe pjesë e korridorit Durrës –Morinë);*
Mamurras -Fushë Krujë *(ky segment është dhe pjesë e korridorit Durrës –Morinë.)*
Fushë Krujë –Vorë –Rrogozhinë (66 km);
Rrogozhinë-Lushnjë; Lushnjë-Fier;
Fier-Tepelenë; Tepelenë-Gjirokastër;
Gjirokastër- Kakavijë.

Korridori Lindje- Perëndim është pjesë e korridori VIII. *(Deti Adriatik – Deti i Zi)* (247 km) i cili kalon ndërmjet Detit Adriatik hyn përmes Portit të Durrësit dhe përfundon në Qafë Thanë në kufi me Maqedoninë.Në këtë korridor përfshihen segmentet
Durrës-Rrogozhinë (ky segment është pjesë dhe e Korridorit Veri-Jug); Rrogozhinë-Elbasan; Elbasan-Librazhd; Librazhd-Qukës; Qukës-Qafë Thanë.

Korridori Durrës–Morinë.
Ndërtimi i rrugës Durrës-Morinë, në kufi me Kosovën, lidh me Prishtinën dhe me Korridorin X dhe Serbinë.
Këtu përfshihen segmentet:
Segmenti Durrës-Milot (ky segment është pjesë e Korridorit Veri-Jug); Segmenti Milot-Rrëshen;
Segmenti Rrëshen-Kalimash;
Segmenti i tretë kalon nga Kalimashi në Kukës dhe në pikën kufitare të Morinës.

II PËRSHKRIMI



Rruga fillon në km 4+400 nga dalja e qytetit të Elbasanit aty ku mendohet të lidhet me By-Pass e Elbasanit dhe perfundon ne km 58+400 me një gjatësi totale rreth 54 km.
Gjerësia e rrugës ekzistuese është 8.1 m pjesë asfaltike dhe dy bankina te paasfaltuara me nga 0.5-0.75 m në të dy anët.
Veprat e artit në rrugën ekzistuese janë:
Në km 4+900 ndodhet një urë mbi një përrua me prurje të mëdha me inerte e cila bllokon shpeshherë këtë aks rrugor.
Në km 6+400 ndodhet një urë antike.
Në km 9+900 ka nënkalim hekurudhor (bahce mbret) dhe në një gjatësi prej 300 ml rruga është me pjerrësi gjatësore10%.
Në km 10+700 ndodhet ura e Xibrakës me HD 50 ml
Në km 12+450 ka një nënkalim hekurudhor.
Nga km 14+400 deri km 15+100 rruga kalon në krahun e djathtë të dy ish tuneleve automobilistikë, sot jashtë përdorimit.
Nga km 15+300 deri km 15+800 rruga kalon mbi tunelin e hekurudhës.
Në km 18+200 ka një urë me HD 20 m.
Në km 18+500 ndodhet Ura e Murrashit me HD 60 m
Në km 20+400 ka një nënkalim hekurudhor dhe dalja e tunelit të hekurudhës.
Në km 23+400 ndodhet Ura ne hyrje të Qytetit të Librazhdit me HD 130 m
Në km 24+000 ndodhet Ura në dalje qytetit të Librazhdit me HD 28 m.
Në km 24+700 ndodhet urë me HD 20 m.
Në km 26+700 dhe 27+700 ka dy nënkalime hekurudhore.
Nga km 27+000 deri në km 29+300 janë pesë ura me HD të ndryshme
Në km 28+200 ka urë me HD 50 m.
Nga km 28+500 ka urë më HD 15 m
Në km 29+300 ka një urë me HD 22 m
Në km 31+700 ka urë me HD 10 m
Në km 33+800 ka urë me HD 60 m
Në km 34+400 ka urë me HD 80 m
Në km 35+300 ka urë me HD 50 m

Në km 36+600 ka urë me HD 20 m
Në km 37+100 ka urë me HD 10 m
Në km 37+400 ka dy ura me HD 20 m
Në km 33+400 ndodhet një urë me HD 20 m
Në km 39+200 ka urë me HD 30 m
Në km 41+400 ndodhet Ura e Bushtricës poshtë mbikalimit hekurudhor me HD 100 m
Në km 42+300 ka urë me HD 20 m
Në km 43+300 ka urë me HD 100 m
Në km 44+500 ka urë me HD 55 m
Në km 45+500 rruga kryqëzohet me rrugën e re Qukës- Qafë Pllocë
Në km 47+200 ka një urë me HD 55 m
Në km 48+800 ka një urë me HD 48 m në fshatin Pishkash
Në km 49+600 ka një urë me HD 40 m
Në km 49+800 ka nënkalim hekurudhor
Në km 50+000 ka urë me HD 40 m
Në km 53+800 është hyrja e qytetit të Përrenjasit
Në km 58+800 ka një urë me HD 10 m degëzimi për fshatin Rajcë.
Në km 56+500 dalja e qytetit të Përrenjasit
Në km 58+400 fillimi i rrugës me tre korsi për në Qafë Thanë.

III QËLLIMI I PUNËS

Ajo cfarë kërkohet në këto Terma Reference është pikërisht studimi dhe hartimi i një projekti të detajuar i një segmenti rrugor të **kategorisë C 2 – e modifikuar sipas standartit 2015,** me gjerësi të pjesës asfaltike 10.5 m dhe dy bankina të paasfaluara me nga 0.75 m. Konsulenti duhet të ketë parasysh mundësinë e zgjerimit me korsi të tretë për parakalimin e mjeteve të tonazhit të rëndë.

Në mënyrë të veçantë:

1. Në km 14+400 deri km 18+500 të bëhet një sudim i detajuar për përmirësimin e gjeometrisë së rrugës duke e sjellë atë në standart mundësinë e kalimit të këtij aksi rrugor me tunel.
2. Në km 23+400 deri tek km 24+000 që është pjesë e qytetit të Librazhdit të studiohet mundësia për kalimin me By Pass.
3. Po kështu në km 53+800 deri km 56+500 e cila është pjesë e qytetit të Përrenjasit të studiohet mundësia për kalimin me By Pass.
4. Rruga duhet të garantojë mos përmbytjen e saj nga vërshimet e ujrave me siguri të përshtatshme për këtë kategori rruge.
5. Rruga të jetë e pajisur me të gjitha elementët urban, trotuare, ndriçim ku kalon në zonat urbane dhe në nyje në nivel
6. Konsulenti duhet të ketë në konsideratë metodat e mundshme të ndërtimit, proçedurat e gërmimit,betonimit, mbrojtjes dhe kufizimet kohore të ndërtimit. Duke patur parasysh se rehabilitimi i këtij aksi do të behet me trafik të pandërprerë.
7. Sinjalistika e projektuar të jetë e plotë dhe sipas standarteve në fuqi dhe apo të përditësuara me standartet europiane.

Konsulenti duhet të mbështetet në standartet shqiptare në fuqi (Rregullin Teknik - 2015) dhe standarteve europiane të miratuara dhe të përditësuara për këto ndërtime dhe kategori rruge.

IV Kërkesat për Konsulentin dhe paraqitja e dokumentacionit.

IV. 1 Projekt-Ideja

Në studimin e këtij objekti Konsulenti duhet të shqyrtojë jo më pak se dy variante, për zgjerimin aksit ekzistues, apo dhe ndërtimin e një aksi të ri në zona të veçanta. Konsulenti duhet të parashikojë masat inxhinierike për mbrojtjen e trupit të rrugës por duke mos e kufizuar atë për të studiuar dhe paraqitur dhe variante apo nënvariante tjera që ai do t'i shohë të arsyeshme t'i paraqesë.
Kryerjen e vëzhgimeve që synojnë në eliminimin e hamendësimeve të bëra gjatë fazave më të hershme.
Përditësimin e llogaritjeve dhe zëvendësimin e hamendësimeve të bëra me parë.
Përgatitjen e metodollogjisë së përgjithshme të ndërtimit.
Përgatitjen e programit të punimeve.
Përgatitjen e vlerësimit të kostos.
Konsultimin me publikun.
Mbi sa më sipër konsulenti gjatë kësaj faze do të përgatisë dhe të paraqesë studimet që vijonë;

Studimi Topografik.

Për këtë qëllim do të kryhet një rilevim i plotë i cili do të hartohet nga Konsulenti dhe të jetë i firmosur dhe vulosur. Studimi duhet të shtrihet dhe në pellgun ujëmbledhës të Shkumbinit

Studimi gjeologjik dhe gjeoteknik .

Ky studim do të paraqesë rezultatet ekzistuese të përfituara prej mostrave të materialeve të nxjerra para fazës së projekt-idesë duke marrë parasysh dhe studimet e bëra në projektet e mëparshme. Studimi gjeologjik dhe gjeoteknik duhet të trajtojë të gjitha çështjet që lidhen me qëndrueshmrinë e dherave dhe trasesë së rrugës ekzistuese, veçanërisht rëndësi të veçantë duhet t'i kushtohet studimit të vendeve ku do të parashikohen veprat e artit.

Rëndësi të veçantë duhet t'i kushtohet studimit gjeologjik të trasesë së rrugës e cila do ndërtohet në zgjerim të asaj ekzistuese.
Studimi do të shoqërohet dhe me fotografi të cilat së bashku me hartat dhe testimet e kryera do të shërbejnë për të konfirmuar rezultatet e përfshira në studimin gjeoteknik. Studimi do të jetë i konfirmuar nga specialisti/ët gjeologo/gjeoteknik apo grupi i projektimit gjeoteknik.

Studimi hidrologjik dhe hidraulik.

Duhet të vlersojë kushtet hidrologjike për gjithë basenin e lumit të Shkumbinit. Duhet të përfshijë llogaritjet hidrologjike të sakta me sigurinë që parshikon standarti në veçanti për prurjet maksimale të ujit, për kohëzgjatjen e tyre dhe për nivelin maksimal të tyre.
Gjithashtu studimi hidrologjik do të përfshijë dhe llogaritjen e prurjeve të ujrave mbi rrugë duke propozuar dhe mënyren e largimit të tyre.
Në përfundim të këtij studimi do të përgatitet Raporti Hidrologjik i cili do të jetë i firmosur nga specialistët përkatës.

Studimi dhe projektimit të shtresave rrugore

Në këtë studim konsulenti do të mbështetet në planin prespektiv të zhvillimit të zonës duke trajtuar projektimin e shtresave rrugore për çdo seksion rrugor. Ky studim do të shtrihet për një periudhë 20-vjecare për materialet fleksibël ndërsa për ato rigjide do të shtrihet për një periudhe 40-vjecare. Studimi do jetë i plotë si për trasenë ekzistuese ashtu dhe për trasene e re që do t'i shërbejë zgjerimit të rrugës. Gjithashtu konsulenti do të ketë në konsideratë dhe shtresat rrugore të aplikuara gjatë rikonstruksionit të këtij segmenti rrugor.
Ky raport do të konfirmohet nga inxhinieri i projektimit të rrugëve apo grupi i projektimit të rrugëve. Konsulentit, pas firmosjes së kontratës do t'i vihen në dispozicion të dhënat e trafikut për të ndihmuar në proçesin e llogaritjes së shtresave rrugore.

Studimi dhe projektimit i urave

Nëse Konsulenti planifikon të mbajë ndonjë urë ekzistuese ose strukturë kullimi, duhet të bëhet një vlerësim i plotë mbi kapacitetin mbajtës të atyre strukturave. Teorikisht, gjerësia e urës dhe gjatësia tombinove duhet të jenë në të njëjtin standard me strukturat e reja të propozuara. Sidoqoftë, mund të ketë struktura me gjerësi të pamjaftueshme për modelin përfundimtar që janë në gjendje të mirë strukturore, dhe zëvendësimi ose përmirësimi i tyre nuk mund të justifikohet ekonomikisht. Mund të ketë gjithashtu disa struktura që mund të ruhen pas marrjes së masave përmirësuese. Ruajtja, riparimi, shtrirja ose zëvendësimi i strukturave ekzistuese duhet të identifikohet dhe arsyetohet qartë

Tombinot dhe strukturat drenazhuese

Konsulenti do të rishikojë modelin hidraulik dhe strukturor të të gjitha tombinove dhe strukturave kulluese ndër-kulluese. Strukturat ekzistuese duhet të përdoren aty ku është e mundur. Sidoqoftë, parashikimi për lëvizjen e trafikut gjatë ndërtimit është thelbësor dhe mund të kërkojë ndërtimin e një strukture të re. Sigurimi i strukturave hyrëse dhe dalëse do të jetë i domosdoshëm, veçanërisht në terrenin malor.

Muret Mbajtës dhe mbrojtja e shpatit

Ka shumë mure mbajtëse dhe struktura të tjera përgjatë rrugës, të cilat mund të përdoren në projektin përfundimtar. Konsulenti do të sigurohet për aftësinë mbajtëse të strukturave të tilla. Në disa vende do të kërkohen mure të reja mbajtëse dhe punime për mbrojtjen e shpatit. Vizatimet e plota strukturore dhe detajet e ndërtimit të të gjitha punimeve të reja të nevojshme duhet të përgatiten në mënyrë që ndërtimi të mund të vazhdojë pa pasur nevojë për ndonjë vizatim shtesë dhe vizatime.

Rrugët sekondare

Duhet t'i kushtohet vëmendje e duhur modelimit të kryqëzimeve me të gjitha rrugët sekondare ngjitur. Vëmendje e veçantë do t'i kushtohet kryqëzimeve kryesore kur kthesat duhet të përshtaten për siguri më të lartë. Mund të pranohet të zhvendoset kryqëzimi me disa rrugëve anësore për arsye sigurie ose ekonomike.

Sinjalistika dhe siguria rrugore

Sinjalistika dhe shenjat rrugore do të identifikohen nga Konsulenti dhe do të hartohen, në përputhje me dokumentin "RREGULLORE PER ZBATIMIN E KODIT RRUGOR" (Zbatimi

i Kodit Rrugor) Kreu II (Shenja dhe shenja standarde në rrugë), si dhe VKM nr. 628, datë 15.07.2015, "Për miratimin e Rregullave Teknike të Projektimit dhe Ndërtimit të Rrugëve". Projekti do të parashikojnë heqjen e shenjave të mëparshme të trafikut dhe barrierat e sigurisë rrugore, kur është e nevojshme, dhe heqjen / ndryshimin e shenjave ekzistuese rrugore për të përmbushur standardet e kërkuara në përputhje me tipin e rrugës në projekt.

Metodologjia e ndërtimit

Konsulenti do të përshkruaj për këtë fazë mënyrën se si do të ndërtohet vepra nga pikëpamja teknike, logjistike dhe programore në përputhje me elementët teknikë të projektit dhe rekomandimet e VNM. Këtu duhen theksuar rreziqet e veçanta në të cilat do të ndeshet kontraktori dhe mënyrat se si do të përballohen ato prej tij. Ky raport do të firmoset nga inxhineri i projektimit të rrugëve apo grupi i projektimit të rrugëve. Konsulenti duhet të qartësojë fazat e ndërtimit dhe të menaxhimit të trafikut meqënëse rruga do të jetë me trafik.

Raporti i shpronësimeve.

Ky raport do të paraqesë një listë të mundshme shpronësimesh për të gjithë variantet që propozohen së bashku dhe me kërkesat dhe procedurat ligjore që duhet të plotësohen në lidhje me projektin.

Kërkesat për leje apo licensa

Në këtë raport konsulenti do të raportojë për lejet apo kërkesat që klienti duhet të marrë gjatë fazave të projektimit dhe ndërtimit të objektit.

Raporti mbi konsultimin e publikut

Ky raport do të përmbledhë të gjitha propozimet e konsultimit me publikun, me aktorët e tjerë të interesuar, me entet shtetërore si Bashkitë në të cilat kalon ky aks rrugor, OSHEE, Ndërmarjet Ujësjellës Kanalizime, ndërmarrjet e shërbimeve telefonike, Instituti i Monumenteve të Kulturës, Agjencia e Shërbimit Arkeologjik, Agjencia Kombëtare e Mjedisit, etj. Projekt-Ideja në këtë fazë do të përmbyllet me raportin teknik në të cilin përmbidhet i gjithë proçesi i të menduarit që ka shërbyer si bazë e punës për hartimin e Projekt-Idesë. Në të përfshihen planimetritë dhe informacione të tjera të rëndësishme siç janë studime të veçanta, foto etj.

Vizatimet

Konsulenti duhet të paraqesë vizatimet e mëposhtme duke organizuar pjesën bazë të dokumentave të kontratës për zbatimin e punimeve.

Horografia në shkallën , 1:5000, ose 1:2000.
Planimetri e rrugës dhe argjinaturës në shkallë 1:1000; 1:500; 1:200
Profil gjatësor H 1:1000 V 1: 100 .
Profila tërthor SH 1: 100; 1:50
Profila tërthor tip SH 1:25; 1:50
Harta e rilevimit topografik SH 1;1000; 1:500; 1:200
Harta hidrologjike SH 1:1 000
Harta gjeologjike SH 1:1 000; 1:500; 1:200.

Vizatime të veprave të artit, të seksioneve të tuneleve, të mbikalimeve dhe nënkalimeve hekurudhore apo rrugore, mureve mbajtës apo pritës SH 1:100 1:50
Harta të ndryshme të ndjeshmërisë mjedisore , të objekteve kulturore dhe arkeologjike nëse ka, për të gjitha variantet SH 1:1 000
Planet vendore të miratuara nga Bashkitë apo Agjencia Kombëtare e Planifikimit të Territorit.

Volumet e punës dhe preventivi.

Konsulenti do të përgatisë volumet e punës respektive për të gjithë kategoritë e punëve të paraqitura në projekt. Volumet do të llogariten në bazë të vizatimeve të projektit. Çmimet njësi për të gjitha punimet përkatëse do të llogariten duke pasur parasysh çmimet mesatare të miratuara me VKM dhe ato që nuk gjenden në manuale të shoqërohen me analiza teknike.

Raporti i Projekt - Idesë pasi firmoset dhe vuloset nga specialistët e firmës konsulente paraqitet tek ARRSH në formë zyrtare për shqyrtim dhe miratim.
Projekt-ideja do të dorëzohet në tre kopje të shkruara dhe në dy kopje në CD në formatin origjinal të punuar (dwg).

IV. 1 Kërkesat për Projekt – Zbatimin

Në këtë fazë dhe mbi bazë të variantit përfundimtar të miratuar të projekt idesë nga KT i A.Rr.Sh-së, Konsulenti do të hartojë projektin e zbatimit i cili përfshin përgatitjen e të gjithë dokumentacionit të nevojshëm.

Konsulenti përgatit projektin përfundimtar, vizatimet e detajuara dhe preventivin përfundimtar. Projekti përfundimtar, specifikimet teknike, preventivi dhe vizatimet duhet të përfshijnë punime të plota civile, detaje arkitekturore, strukturore, mekanike dhe elektrike të projektimit dhe vizatime për të gjithë fazat e punimeve në detaje të mjaftueshme që ndërtimi të mund të kryhet pa qenë e nevojshme për modifikime të mëtejshme ose modifikime të vizatimeve. Projekti duhet të përfshijë specifikimet teknime të të gjithë materialeve që do të vendosen në vepër.

Raporti Përfundimtar i studimit Topografik

Raporti përfundimtar i Studimit Topografik duhet të përmbajë të gjithë informacionin e rëndësishëm topografik i cili nevojitet gjatë fazës së hartimit të projektit të zbatimit si dhe të asaj së zbatimit të punimeve. Varianti përfundimtar dhe i miratuar i zgjidhjes së planimetrisë i përcaktuar tashmë dhe i fiksuar në harta dixhitale duhet që për këtë fazë të fiksohet edhe në terren nëpërmjet pikave kryesore të rrjetit koordinativ, të cilat duhet të kenë koordinatat dhe kuotat përkatëse. Këto pika do t'i shërbejnë ndërtuesit për piketimin përfundimtar të aksit në terren, gjithashtu të fiksohen në terren piketat. Sistemi koordinativ i hartimit të hartave topografike do teë jetë sistemi shtetëror i miratuar.
Në këtë fazë Konsulenti do të paraqesë një raport të saktë të vendodhjes së piketave kryesore të vendosura prej tij për zbatimin e punimeve.
Raport i veçant topografik do të përgatitet për veprat e mëdha të artit si tunele mbikalime apo nënkalime hekurudhore si dhe urat.
Të gjitha kuotat e rrugës do të jenë absolute dhe të fiksuara në repera fikse betoni.

Në çdo rast me fillimin e punimeve nga kontraktori fitues, konsulenti do të jetë prezent për dorëzimin e këtyre piketave.

Raporti përfundimtar i Studimit Gjeologjik dhe Gjeoteknik.

Konsulenti në përgatitjen e këtij raporti duhet të rishikojë edhe një herë raportin Gjeoteknik dhe atë Gjeologjik të përgatitur në variantin e projekt-idesë duke e plotësuar atë me informacione shtesë apo të dala gjatë shqyrtimit të projekt- idesë në A.Rr.Sh.
Studimi gjeologjik duhet të jetë i saktësuar duke përfshirë të gjithë dukurinë, aksin, këndin dhe analizën e saktë gjeomorfologjike të zonave ujëmbledhëse dhe të lagështa, nëse ka.
Raporti i Studimit Gjeoteknik duhet të përpilohet për secilën dukuri fiziko-gjeologjike të trajtuar dhe për secilin nën objekt të veprës duke përfshirë dhe materialet e ndërtimit.
Raport i veçantë duhet të plotësohet për tunelet mbikalimet apo nënkalimet.
Raporti i Studimit Gjeoteknik do të ketë përmbajtjen si më poshtë:
- teksti i raportit, parametrat gjeoteknik të projektimit.
- materiali grafik, harta, planimetritë, prerjet gjeologo-inxhinierike dhe në mënyrë të veçantë të testimeve apo shpimeve.
- fotografi ilustrative.
- konkluzionet dhe rekomandimet e grupit të studimit.

Raporti përfundimtar i Studimit Hidrologjik.

Konsulenti në përgatitjen e këtij raporti duhet të rishikojë edhe një herë raportin Hidrologjik të përgatitur në variantin e projekt-idesë duke e plotësuar atë me informacione shtesë apo të dala gjatë shqyrtimit të projekt- idesë në A.Rr.Sh.
Studimi hidrologjik duhet të jetë i saktësuar duke përfshirë të gjithë dukuritë, pellgun ujëmbledhës të Shkumbinit apo dhe të prurjeve tjera e përgjatë aksit rrugor.
Raporti i Studimit hidrologjik duhet të përpilohet për secilin segment duke përllogaritur dhe marrë parasysh dhe reshjet shumëvjeçare të zonës në studim me siguri të përshtatshme për vetë kategorinë e objektit që projektohet.
Raport i veçantë duhet të plotësohet për prurjet maksimale të lumit, nivelet e tij dhe mënyrat e shkarkimit të tyre pa ndikuar apo pa u kapërdedhur mbi rrugë.
Raporti i Studimit Hidrologjik do të ketë përmbajtjen si më poshtë:
- teksti i raportit, parametrat llogaritjet hidrologjike dhe pellgjet ujëmbledhëse.
- materiali grafik, harta, planimetritë.
- konkluzionet dhe rekomandimet e grupit të studimit.

Raporti përfundimtar i llogaritjeve statike dhe dinamike

Në këtë fazë Konsulenti do të paraqesë raportin përfundimtar të llogaritjeve statike dhe dinamike për veprat e artit: ura, tunele, mbikalime, nënkalime, tombino, mure mbajtës apo pritës etj.
Raporti duhet të jetë i detajuar dhe duhet të përmbajë: standartin e përdorur për llogaritjet mbi të cilat është hartuar projekti i tyre, ngarkesat, modelimi, rezultatet dhe interpretimin i rezultatave.
Raporti të jetë i firmosur nga Projektuesi.

Përgatitja e metodologjisë përfundimtare të punimeve të ndërtimit

Pas përpunimit të projektit dhe hartimin e projektit përfundimtar të zbatimit Konsulenti duhet të kryej rishikimin e metodologjisë së ndërtimit. Metodologjia e ndërtimit ndërmjet të tjerave duhet t'i referohet dhe çështjeve mjedisore, çështjeve të monumenteve të kulturës apo historike të cilave duhet t'i kushtojë vëmendje Kontraktori.

Këtu Konsulenti do të japë dhe propozimin e tij për vendet e marrjes materialeve që do shërbejnë për lëndë të parë në ndërtimin e objektit, cilësinë dhe specifikimet e tyre.
Në këtë fazë gjithashtu, Konsulenti do të përshkruajë dhe punimet ndihmëse, nevojat e ndërtimit të rrugëve, të furnizimit të spostimeve të ndryshme elektrofonike, të masave për devijimin e pjesshëm të trafikut apo të tjera që dalin gjatë ndërtimit të veprës.
Konsulenti do të përshkruajë në mënyrë të veçantë dhe masat e marra për sigurinë rrugore përfshirë dhe sinjalistikën. Konsulenti do të hartojë metodologjinë që do punohet në trafik të pandërprerë dhe të përshkruajë masat që do marri për sinjalistikën dhe sigurinë rrugore.

Raporti përfundimtar i shpronësimeve

Konsulenti në këtë fazë do të rishikojë investigimet e kryera në fazën e projekt-idesë duke përshkruar tashmë në mënyrë të qartë dhe të hollësishme listën e pronarëve që shpronësohen, sipërfaqet e tyre, llogaritjet e sipërfaqeve si dhe vlerën e plotë të shpronësimit. Konkretisht në këtë fazë konsulenti duhet të paraqesë:

1.Planimetri Shpronësimi (në formatin A3) mbi harta kadastrale e vulosur nga projektuesi, në të cilën të jenë të dhënat e pronës që shpronësohet si më poshtë:
a. Emër, Atësi, Mbiemër
b. Numër pasurie, zonë kadastrale, sipërfaqe shpronësimi
c. Të jenë të rilevuara objektet dhe të përcaktohen me ngjyrë të kuqe objektet që preken nga realizimi projektit.
2.Planimetri shpronësimi (në formatin A3) mbi fotografimin ajror të vitit 2015, në të cilën të jenë të dhënat e pronës që shpronësohen si më poshte:
a. Emër, Atësi, Mbiemër
b. Numër pasurie, zonë kadastrale, sipërfaqe shpronësimi
c. Të jenë të rilevuara objektet dhe të përcaktohen me ngjyrë të kuqe objektet që preken nga realizimi projektit.

Për pikat 1 dhe 2, duhet që të jetë një vijë shpronësimi e mbyllur (poligon i mbyllur), në të cilin të jenë të konturuara me hatch të lehtë të gjitha sipërfaqet që shpronësohen.

3. Planimetri shpronësimi (në formatim DWG, sistemi koordinativ UTM) mbi hartat kadastrale.
4. Planimetri shpronësimi (në formatin DWG, sistemi koordinativ UTM), mbi fotografimin ajror të vitit 2015
5. Lista e pasurive që shpronësohen, e cila duhet të përmbajë:
a. Emër, Atësi, Mbiemër
b. Numër Pasurie
c. Zonë Kadastrale
d. Sipërfaqe totale e pasurisë
e. Sipërfaqe shpronësimi
f. Lloji i pasurisë
6. Kartelat dhe hartat për të gjitha pasuritë që preken (të jenë brenda afatit 1 mujor)
a. Kartelat dhe hartat duhet të kenë vulën lidhëse të institucionit (A.SH.K përkatëse)
b. Kartelat duhet të kenë faqen e pasme (Seksioni d dhe e)
c. Në rast se një kartelë rezulton e mbyllur duhet të ketë kartelën vijuese.

RAPORTI I VLERËSIMIT TË NDIKIMIT NË MJEDIS

Projekti " **Studim Projektim, zgjerimi i segmentit rrugor dalje Elbasan-Përrenjas-Qafë Thanë"** i nënshtrohet proçedures së vlerësimit paraprak të VNM-së. Hartimi i Raportit të VNM-së dhe Relacionit Teknik duhet të bazohet në: Vendimin Nr. 686, datë 29.7.2015 ''Për Miratimin e Rregullave, të Përgjegjësive e të Afateve për Zhvillimin e Proçedurës së Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis (VNM) dhe proçedurës së Transferimit të Vendimit të Deklaratës Mjedisore''.

PER FAZËN E PROJEKT-ZBATIMIT konsulenti do të dorëzojë:

1. **Raportin paraprak të VNM-së**

2. **Relacionin Teknik të projektit të propozuar**

1. Në Raportin paraprak të VNM-së, duhet të përfshihen:

a) përshkrimi i mbulesës bimore të sipërfaqes ku propozohet të zbatohet projekti, shoqëruar dhe me fotografi;

b) informacion për praninë e burimeve ujore, në sipërfaqen e kërkuar nga projekti dhe në afërsi të tij;

c) informacion lidhur me identifikimin e ndikimeve të mundshme, negative, në mjedis, të projektit, përfshirë ndikimet në biodiversitet, ujë, tokë dhe ajër;

ç) një përshkrim për shkarkimet e mundshme në mjedis, të tilla si: ujëra të ndotura, gaze dhe pluhur, zhurma, vibrime, si dhe për prodhimin e mbetjeve;*(Duhet të identifikohen venddepozitimet për mbetjet e ngurta të autorizuara nga pushteti vendor.)*

d) informacion për kohëzgjatjen e mundshme të ndikimeve negative të identifikuara;

dh) të dhëna për shtrirjen e mundshme hapësinore të ndikimit negativ në mjedis, që nënkupton distancën fizike nga vendndodhja e projektit, dhe vlerat e ndikuara që përfshihen në të;

e) mundësinë e rehabilitimit të mjedisit të ndikuar dhe mundësinë e kthimit të mjedisit të ndikuar të sipërfaqes në gjendjen e mëparshme, si dhe kostot financiare të përafërta për rehabilitimin;

ë) masat e mundshme për shmangien dhe zbutjen e ndikimeve negative në mjedis;

f) ndikimet e mundshme në mjedisin ndërkufitar (nëse projekti ka natyrë të tillë).

2. Në Relacioni Teknik të projektit të propozuar, duhet të përfshihen:

a) qëllimin e projektit të propozuar;

b) planimetrinë e vendndodhjes së projektit, ku të pasqyrohen në hartë topografike kufijtë e sipërfaqes, të shoqëruar me koordinatat, sipas sistemit koordinativ GAUS KRUGER, fotografi dhe të dhëna për përdorimin ekzistues të sipërfaqes që do të përdoret përkohësisht apo përherë nga projekti, gjatë fazës së ndërtimit apo funksionimit të veprimtarisë;

c) informacionin për qendrat e banuara, në zonën ku propozohet të zbatohet projekti, shoqëruar me fotografi dhe të dhëna për distancën e tyre nga vendndodhja e projektit të propozuar, si dhe përcaktimin e njësisë së qeverisjes vendore që administron territorin ku propozohet projekti;

ç) skicat dhe planimetritë e objekteve dhe strukturave të projektin, si dhe mënyrat dhe metodat që do të përdoren për ndërtimin e objekteve dhe strukturave të projektit;

d) përshkrimin e proceseve ndërtimore dhe teknologjike, përfshirë kapacitetet prodhuese /përpunuese, sasitë e lëndëve të para dhe produktet përfundimtare të projektit;

dh) informacionin për infrastrukturën e nevojshme për lidhjen me rrjetin elektrik, furnizimin me ujë, shkarkimet e ujërave të ndotura dhe mbetjeve, si dhe informacionin për rrugët ekzistuese të aksesit apo nevojën për hapje të rrugëve të reja;

e) programin për ndërtimin, kohëzgjatjen e ndërtimit, kohëzgjatjen e planifikuar për funksionimin e projektit, kohën e mundshme të përfundimit të funksionimit të projektit dhe, sipas rastit, edhe fazën e planifikuar të rehabilitimit të sipërfaqes, pas mbarimit të funksionimit të projektit;
ë) lëndët e para që do të përdoren për ndërtimin dhe mënyra e sigurimit të tyre (materiale ndërtimi, ujë dhe energji);
f) informacionin për lidhjet e mundshme të projektit me projekte të tjera ekzistuese përreth/pranë zonës së projektit;
g) informacionin për alternativat e marra në konsideratë, për sa i takon përzgjedhjes së vendndodhjes së projektit dhe teknologjisë që do të përdoret;
gj) të dhënat për përdorimin e lëndëve të para gjatë funksionimit, përfshirë sasitë e ujit të nevojshëm, të energjisë, lëndëve djegëse dhe mënyrën e sigurimit të tyre;
h) aktivitete të tjera që mund të nevojiten për zbatimin e projektit, si ndërtimi i kampeve apo rezidencave etj.;
i) informacionin për lejet, autorizimet dhe licencat e nevojshme për projektin, në përputhje me përcaktimet e bëra në legjislacionin në fuqi, si dhe institucionet kompetente për lejimin / autorizimin/ licencimin e projektit;
j) kopje të lejeve, autorizimeve dhe licencave që disponon zhvilluesi për projektin e propozuar, në përputhje me përcaktimet e bëra në legjislacionin në fuqi, si dhe institucionet kompetente për lejimin / autorizimin/licencimin e projektit.

Përgatitja e dokumentacionit të nevojshëm për marrjen e Lejeve si më poshtë:

- Përgatitja e dokumentacionit të nevojshëm për marrjen e Lejeve Mjedisore ,bazuar në ligjin Nr. 10440, date 07.07.2011'' PËR VLERËSIMIN E NDIKIMIT NË MJEDIS'' (VNM-së) të ndryshuar, dhe VKM nr. 686, datë 29.07.2015 ''Për miratimin e rregullave, të përgjegjësive e të afateve për zhvillimin e proçedurës së Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis (VNM) dhe proçedurës së transferimit të vendimit e deklaratës mjedisore" për objektet që do të ndërtohen.

- Mendimi nga Agjencia Kombëtare e Zonave të Mbrojtura përpara mitatimit të projektit zbatimit nga Këshilli Teknik i ARRSH-së.

- Përcaktimi i venddepozitim të interteve nga Njësi e Vetëqeverisjes Vendore(NJVV)

- Përgatitja e dokumentacionit të nevojshëm në bazë të ligjit Nr. 27/2018, ''Për Trashëgiminë Kulturore dhe Muzetë'' dhe aplikimi pranë Institutit të Monumenteve të Kulturës për Vendimin nga Këshilli Kombëtar i Restaurimeve për objektin që do të ndërtohen përpara miratimit të projektit zbatimit nga Këshilli Teknik i ARRSH-së.

- Përgatitja e vëzhgimi arkeologjik për Agjencinë e Shërbimit Arkeologjik bazuar në ligjin Nr.9048, date 07.04.2003 "PËR TRASHËGIMINË KULTURORE" i ndryshuar .

- Përgatitja e dokumentacionit të nevojshëm bazuar në ligjin Nr. 107/2014 datë 31.07.2014 ''Për Planifikimin dhe Zhvillimin e Territorit'' i ndryshuar dhe në Vendimin Nr. 408, datë 13.05.2015 për aplikimin e Lejes së Infrastrukturës nga ARRSH-së.

- Përgatitja e dokumentacionit për heqjen nga fondi pyjor në mbështetje të VKM nr.1353, datë 10.10.2008 "Për përcaktimin e rregullave për paraqitjen e kërkesës, mbajtjen dhe plotësimin e dokumentacionit teknik, si dhe të kritereve e të proçedurave të zvogëlimit të sipërfaqes e të vëllimit të fondit pyjor", i ndryshuar, si dhe të VKM nr.1374, datë 10.10.2008 "Për përcaktimin e rregullave dhe të proçedurave që ndiqen për heqjen, shtimin dhe ndryshimin e destinacionit të fondit kullosor",

- Përgatitja e dokumentacionit të nevojshëm për kërkesën ''Për përdorim të burimeve ujore për veprimtari ndërtimore në brigje'', Bazuar në Ligjin Nr. 111/2012 datë 15.11.2012 "Për menaxhimin e integruar të burimeve ujore" si dhe Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr.416, datë 13.5.2015 "Për miratimin e kushteve të posaçme, dokumenteve shoqëruese, afatin e vlefshmërisë, formularëve të aplikimit për autorizim dhe leje, procedurave të shqyrtimit dhe vendimmarrjes, si dhe formateve të autorizimit dhe lejes për përdorim të burimeve ujore".

Volumet e punës dhe preventivi

Bazuar në llogaritjet dhe vizatimet e projektit Konsulenti do të hartojë një listë me me të gjitha zërat e punimeve që janë pjesë përbërse e listës përfundimtare të volumeve (Preventivi).
Preventivi do të shoqërohet me tabelat e volumeve dhe mënyrën e llogaritjes tyre. Çmimet do të jenë ato njësi të miratuara me VKM. Një kopje të listës së çmimeve njësi në rast se Konsulenti nuk arrin ta marrë nga fletoret zyrtare mund ta marrë në cdo kohë pranë A.Rr.Sh-së. Zërat e punimeve që nuk janë përfshirë në listën e çmimeve njësi të miratuara, Konsulenti do t'i shoqërojë me analizën teknike të çmimit..
Projektuesi/konsulenti duhet të paraqesë bashkëngjitur preventivit një përmbledhëse me të dhënat tekniko-ekonomike të projektit ku të perfshihen, por pa u kufizuar:
Kategoria e rrugës, gjatësia, gjërësia, pozicioni gjeografik, veprat e artit përgjatë rrugës dhe vlera ndërtimore e objektit.
Kosto për km të objektit.
Kosto për km nëse ka të rrugëve dytësore/ shërbimit etj.
Kosto për km të veprave inxhinierike të vogla /të mëdha/ura/nyje/mbrojtje lumore/masa inxhinierike/tombino/mure pritës dhe mbrojtës/nënkalime/mbikalime/tunele etj.
Kosto për km për sinjalistiken dhe sigurinë rrugore.
Të tjera sipas natyrës dhe llojit të ndërhyrjes në infrastrukturën rrugore.

Kërkesat për leje

Në këtë fazë Konsulenti duhet të konsultohet me legjislacionin në fuqi dhe të plotësojë sipas tij dikumetacionin e nevojshëm si:

Përgatitja e dokumentacionit të nevojshëm për marrjen e Lejeve Mjedisore, bazuar në ligjin Nr. 10440, date 07.07.2011'' PËR VLERËSIMIN E NDIKIMIT NË MJEDIS'' (VNM-së) të ndryshuar, dhe VKM nr. 686, datë 29.07.2015 ''Për miratimin e rregullave, të përgjegjësive e të afateve për zhvillimin e proçedurës së Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis (VNM) dhe proçedurës së transferimit të vendimit e deklaratës mjedisore" për objektet që do të ndërtohen.
Mendimi nga Agjencia Kombëtare e Zonave të Mbrojtura përpara miratimit të projektit zbatimit nga Këshilli Teknik i ARRSH-së.
Përcaktimi i vend-depozitim të interteve nga Njësia e Vetëqeverisjes Vendore(NJVV)
Përgatitja e dokumentacionit të nevojshëm në bazë të ligjit Nr. 27/2018," Për Trashëgiminë Kulturore dhe Muzetë'' dhe aplikimi pranë Institutit të Monumenteve të Kulturës për Vendimin

nga Këshilli Kombëtar i Restaurimeve për objektin që do të ndërtohen përpara mitatimit të projektit zbatimit nga Këshilli Teknik i Arrsh-së.
Përgatitja e vëzhgimi arkeologjik për Agjencinë e Shërbimit Arkeologjik bazuar në ligjin Nr.9048, date 07.04.2003 "PËR TRASHËGIMINË KULTURORE" i ndryshuar.

Përgatitja e dokumentacionit të nevojshëm bazuar në ligjin Nr. 107/2014 datë 31.07.2014 ''Për Planifikimin dhe Zhvillimin e Territorit'' i ndryshuar dhe në Vendimin Nr. 408, datë 13.05.2015 për aplikimin e Lejes së Infrastrukturës nga ARRSH-së.

Përgatitja e dokumentacionit për heqjen nga fondi pyjor në mbështetje të VKM nr.1353, datë 10.10.2008" Për përcaktimin e rregullave për paraqitjen e kërkesës, mbajtjen dhe plotësimin e dokumentacionit teknik, si dhe të kritereve e të proçedurave të zvogëlimit të sipërfaqes e të vëllimit të fondit pyjor", i ndryshuar, si dhe të VKM nr.1374, datë 10.10.2008 "Për përcaktimin e rregullave dhe të proçedurave që ndiqen për heqjen, shtimin dhe ndryshimin e destinacionit të fondit kullosor",

Përgatitja e dokumentacionit të nevojshëm për kërkesën ''Për përdorim të burimeve ujore për veprimtari ndërtimore në brigje'', Bazuar në Ligjin Nr. 111/2012 datë 15.11.2012 "Për menaxhimin e integruar të burimeve ujore" si dhe Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr.416, datë 13.5.2015 "Për miratimin e kushteve të posaçme, dokumenteve shoqëruese, afatin e vlefshmërisë, formularëve të aplikimit për autorizim dhe leje, procedurave të shqyrtimit dhe vendimmarrjes.

Përgatitja e raportit përfundimtar teknik të projektit të zbatimit.

Raporti i projektit të zbatimit do të përfshijë të gjithë informacionin e mësipërm si dhe të reflektojë në trajtë të shkruar arsyet mbi të cilat është bazuar hartimi i detajuar i projektit.
Bashkëngjitur me këtë raport do të jenë në origjinal të gjitha miratimet, lejet apo propoziomet e aktorëve pjesmarrës dhe të interesuar si Pushteti Lokal, ASHK, ALUIZNI, DPUK, OSHEE, ALBTELEKOM, KKR (Këshilli Kombëtar i Restaurimeve) mendimin nga Agjencia Kombëtare e Zonave të Mbrojtura (AKZM), etj.
Për vetë specifikën e këtij projekti Drafti i raportit perfundimtar të projektit të zbatimit do të ketë datë dhe të jetë i firmosur dhe do të paraqitet në formë zyrtare tek A.Rr.Sh-së për shqyrtim dhe miratim.
Së bashku me këtë raport do të jenë dhe specifikimet teknike për materialet për punën në zbatim, cilësia e tyre dhe standarti për përdorimin e tyre.
Specifikimet për zbatimin e punimeve për zërat e punës që parashikon preventivi.
Cilësinë e materialeve dhe standartin për përdorimin e tyre.

Vizatimet

Konsulenti në fazën e projektit të zbatimit në formë grafike duhet të sjellë vizatimet e mëposhtme duke organizuar pjesën bazë të dokumentave të kontratës për zbatimin e punimeve.

Horografia në shkallën 1: 5 000 Në raste që zona e studimit është shumë e madhe duhet të pregatitet nje hartë përmbledhëse në një shkallë të përshtatshme.
Planimetri e hollësishme në shkallë 1:1 000; 1:500; 1:200.
Profil gjatësor H 1:1000 V 1: 100 dhe H 1;500 V 1:100.
Profila tërthor SH 1: 100; 1: 50
Profila tërthor tip SH 1:25; 1:50.
Profilat tip të tunelit, mbikalimeve apo nënkalimeve hekurudhore SH 1;25, 1:50

Projekt të detajuara të urave apo mbrojtjeve lumore të rrugës të propozuar në projekt.
Harta e rilevimit topografik SH 1:1 000; 1:500; 1:200.
Harta hidrologjike SH 1:1000, 1;500.
Harta gjeologjike SH 1:1000; 1:500; 1:200.
Vizatime të seksioneve të tunelit , mureve mbajtes apo pritës etj SH 1: 50; 1: 100
Harta të ndryshme të ndjeshmërisë mjedisore, të objekteve kulturore dhe arkeollogjike nëse ka, për të gjitha variantet SH 1:1 000
Planimetritë e shpronësimeve SH 1:1000 ; 1:500.
Planimetria e shpronësimit (e hedhur në sistemin koordinativ KRRGJSH/UTM zone 34) dhe vijën e saktë të shpronësimit shoqëruar me ortofoto dhe hartat treguese. Zonat ku do të merren materialet e ndërtimit lëndë e parë përfshirë dhe punimet e përkohëshme vendet e depozitimive etj SH 1:1000
Sinjalistika vertikale dhe horizontale dhe mbrojtja rrugore SH: 1;100, 1;500
Plani i devijimit te trafikut të përkohshëm dhe sinjalistika për këtë qëllim.
Plani i sigurimit teknik në punimet në rrugë.

Kushtet dhe mënyra e dorëzimit të projektit të zbatimit.
Pas shqyrtimit te tij ne kt Konsulenti do te sjelle nje kopje projektit te plote te zbatimit per shqyrtim dhe miratim. Me pas kons do pregatis projektin se bashku me ndryshimet e propozuara nga kt , se bashku me projektin do te jet preventivi specifikimet grafiku i punimeve metodologjia e punimeve, plani menaxhimitte trafikut etj.
Pas kthimit të draft raportit me vërjtje nga A.R.Sh-ja, Konsulenti do të pregatisë dhe dorëzojë në rrugë zyrtare në A.Rr.Sh projektin e plotë të zbatimit së bashku me Raportin Përfundimtar, Specifikimet teknike dhe Preventivin përfundimtar. Draft raporti të dorëzohet një kopje në format A-4.
Projekti do të dorëzohet në forme të shkruar në 3 kopje të firmosura në origjinal dhe në formatet e kërkuara ..
Projekti i Zbatimit do të dorëzohet në tre kopje elektronike (në disk, DVD,CD) në formatin origjinal të punuar ose kompatibël me programet Cad,ArchGis etj. Në menyrë elektronike do të dorëzohen dhe raportet, preventivi dhe specifikimet teknike. Ato duhet të jenë në formatin origjinal të punuar.
Një kopje e projektit duhet të sillet në mënyrë elektronike dhe e firmosur elektronikisht. Përvec kësaj Konsulenti do të pregatisë një kopje elektronike me pjesët kryesore të projektit në format "PDF" së bashku me raportin përfundimtar dhe specifikimet teknike.

4. Koha dhe Dorëzimi i Dokumentave

Sipas kushteve të kontratës dorëzimet bëhen:
Projektideja - jo më shumë se 3 muaj nga data e nënshkrimit të kontratës.
Drafti i projektzbatimit jo më vonë se 4 muaj nga data e miratimit të projekt idesë, ndërsa dorëzimi i projektit të plotë të zbatimit- jo më vonë se 9 muaj nga data e nënshkrimit të kontratës.
Dorëzimi i projektit të zbatimit do të bëhet në rrugë zyrtare shoqëruar me fletë inventari. Ato duhet të jenë të firmosura dhe të vulosura në origjinal nga projektuesit.
Bashkëngjitur me projektin duhet të sillen edhe miratimet apo variantet e Pushtetit Lokal ose të institucioneve të sipërpërmendura që kanë bashkëpunuar dhe që janë pjesëmarrës dhe aktorë në këtë projekt.

Përgatitur nga Grupi i Punës